



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE E UJËSJELLËS KANALIZIME VLORË SH.A

Nr. _____ Prot.

Vlorë më ____/____/2024

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Dt.21.10.2024

Drejtuar: Operatorit ekonomik LIGUS sh.p.k

(Adresa: *Bulevardi Bajram Curri, Rruga Aleks Buda, Pallati I Jon 2002, Tirane Tiranë, Shqipëri*)

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedure e Hapur Mallra**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje Materiale Hidraulike ” nr REF-17567-08-30-2024** me fond limit: **28,833,000** (njetzet e tete milion e teteqind e tridhjetë e tre mijë) **lekë pa TVSH** .

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. ALPHA SOLUTIONS GROUP shpk
Emri i plotë i shoqërisë

Nipt:L63620402U
Numri i NIPT-t

Vlera: 21,624,751 (*njetzete e nje milion e gjashteqind e njetzete e kater mijë e shtateqind e pesedhjetë e nje*) **leke pa TVSH;**
(*e shprehur në shifra dhe fjalë*)

2. LIGUS sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

Nipt:L51523001S
Numri i NIPT-t

Vlera: 25,576,360 (*njetzet e peze milion e peseqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtedhjetë*) **Leke pa TVSH**
(*e shprehur në shifra dhe fjalë*)

Etj. _____

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. ALPHA SOLUTIONS GROUP shpk

Emri i plotë i shoqërisë

Nipt:L63620402U

Numri i NIPT-t

Vlera: 21,624,751 (njezete e nje milion e gjashteqind e njezete e kater mije e shtateqind e pesedhjete e nje) **leke pa TVSH;**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

1. Ne piken 2.5 thuhet se: *Operatori Ekonomik per te kryer procesin e Furnizimit prane AK, duhet te disponoje minimumi nje mjet transporti ne pronesi ose me qera me kapacitet mbajtës jo me pak se 3500 kg. Per te vertetuar keto OE duhet te paraqese vertetim per pronesine ose Kontrate Qeraje, shoqeruar me Lejen e Qarkullimit dhe Lejen e Transportit, te leshuar nga Organet perkatese. Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën, ne kopje origjinale ose te noterizuara, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Operatori ekonomik Alfa Solutions Group shpk ka paraqitur kontratën e qerasë dt. 23.09.2024 me palë qeradhënëse Guri Bani Person fizik. Nga verifikimi i dokumentacionit të mjetit të marrë me qera ky subject zotëron certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vet. Çertifikata e mjetit të cilin e disponon Guri Bani Person Fizik është dhënë në përdorim të vet këtij subjekti për kryerjen e transportit të mallrave (për llogari të veprimtarisë së vet).

Në nenin 81 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] 1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike. 2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik 3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët. 4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit. 5. Përdorimi nga të tretët përfshin: a) dhënien me qira pa drejtues mjeti; b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish; c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh; d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve; e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave; f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] 3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi. 3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. [...]”

Në nenin 41 të ligjit Nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, është përcaktuar se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”.

Në pikën 2.1, të kapitullit I të Vendimit nr.325, datë 19.03.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, i ndryshuar parashikohet se: “2.1 Transporti i mallrave dhe udhëtarëve lejohet të kryhet, nga ndërmarrje të transportit, për të tretë ose me qira, vetëm kur janë pajisur me: a) licencën përkatëse në transportin rrugor, për të tretë ose me qira, të mallrave ose udhëtarëve, brenda vendit; b) licencën përkatëse në transportin ndërkombëtar rrugor, për të tretë ose me qira, të mallrave ose udhëtarëve”.

Pra, Operatori ekonomik Alfa Solutions Group shpk nuk përmbush kriterin e sipërcituar pasi duke qenë se mjeti është marrë me qera, certifikata e transportit e mjetit duhet të jetë për transport mallrash për llogari të tretëve dhe me qera. Nga dokumentacioni i paraqitur ky mjet rezulton të jetë për përdorim vetjak dhe si i tillë nuk mund ti jepet një pale të tretë.

2.Për zërin me numrin rendor në preventiv 25 “Saraçineskë G me flanaxha Dn 65 me volant” Operatori ekonomik Alfa Solutions Group shpk ka paraqitur mostër të markës Fluido Valves (kompani kineze) ndërsa në ofertën teknike kompania prodhuese është shënuar Fucoli Somepal-Fundicao De Ferro S.A (kompani portugeze). Gjithashtu katalogu i paraqitur është i kompanisë portugeze.

3.Për zërin me numrin rendor në preventiv 41 “Fasheta PE φ 160 x 2 PN 16” është paraqitur mostra PN 10 kur është kërkuar PN 16.

4.Për zërin me numrin rendor në preventiv 48 “Manikota PPR 1 X 1/2” Operatori ekonomik Alfa Solutions Group shpk ka paraqitur mostër të markës Plastherm ndërsa në ofertën teknike kompania prodhuese është shënuar Pestan. Gjithashtu katalogu i paraqitur është i kompanisë Pestan.

5.Për zërin me numrin rendor në preventiv 54 “Manikota EF φ 63 PN 16” Operatori ekonomik Alfa Solutions Group shpk ka paraqitur mostër të markës Plastitalia ndërsa në ofertën teknike kompania prodhuese është shënuar ESCOFET, GUICH I BUSQUETS, S.A.

6.Për zërin me numrin rendor në preventiv 91 “Brryl EF φ 110 PN 16” Operatori ekonomik Alfa Solutions Group shpk ka paraqitur mostër të markës Plastitalia ndërsa në ofertën teknike kompania prodhuese është shënuar ESCOFET, GUICH I BUSQUETS, S.A.

7.Për zërat me numër rendor 34 “Fashetë riparimi inoksi 500 MM 88-108” dhe 35 “Fashetë riparimi inoksi 500MM 159-170” në specifikime është kërkuar 500 MM ndërsa në katalogun e paraqitur nuk tregohet që këta zëra të kenë këtë gjerësi.

8.Operatori Ekonomik Alfa Solution Group shpk ka paraqitur autorizim prodhuesi nga ESCOFET, GUICH I BUSQUETS, S.A. ku nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ESCOFET, GUICH I BUSQUETS, S.A. është distributor i prodhuesit Zhejiang Èeixing Në Building Materials Co ltd. Në ofertën teknike është plotësuar si prodhues ESCOFET, GUICH I BUSQUETS, S.A dhe jo Zhejiang Weixing New Building Materials Co ltd me emërtimin ndërkombëtar Vasen.

9.Për zërin me numër rendor 106 “Niples Zingato 1 ¼” në ofertën teknike është shënuar kodi 5907791612373, produkt i cili nuk është zingato, por hekur i zi, pa procesin e zinkimit.

10.Për zërin me numër rendor 122 “Pastë Hidraulike” është paraqitur katalogu italisht nga prodhuesi Raci Srl për modelin 14005. Katalogu është përkthyer nga përkthyesja Jonida Tatazi, përkthyes e gjuhës angleze dhe jo e gjuhës italiane sic përcaktohet në vërtetim përkthimin e nr. rep 5083, datës 25.09.2024. Bazuar në listën e përkthyesve zyrtar të publikuar nga Ministria e Drejtësisë, Jonida Tatazi figuron si përkthyes e gjuhës angleze dhe jo italiane.

11.Për zërin me numër rendor 120 “Vula” forca në tërheqje dhe rezistenca në thyerje nuk është e reflektuar në dokumentacionin e prodhuesit Gockerplast në sistem.

12.Për zërin me numër rendor në preventiv 121 “Tel për vula” në ofertën teknike është vendosur kodi GP150, të dhënat e të cilit nuk janë të reflektuar në katalogun e paraqitur.

13.Për zërin me numër rendor 119 “Adaptor EF 315 X 200 PN 16” është kërkuar që materiali të jetë PE 100-RC, ngjyrë e zezë, si dhe tensioni i shkrires duhet të jetë 30-48 V. Në dokumentacionin e paraqitur nuk janë të reflektuara këto të dhëna. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur certifikatë që tregon se produkti është konform standartit EN 12201-3:2001 ose ekuivalent.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **LIGUS sh.p.k** me NIPT **L51523001S** me adrese: (*Bulevardi Bajram Curri, Rruga Aleks Buda, Pallati I Jon 2002, Tirane*), se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **25,576,360** (*njezet e pese milion e peseqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtedhjetë*) **Leke pa TVSH** / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ADMINISTRATOR

SOKOL KANANAJ